SKEDË TEKNIKE

# RÖFIX AG 610 Bianco FLEX S1




Ngjitës Flex C2 TE S1

## Fushat e përdorimit

Ngjitës pllakash shtresë-hollë e bardhë natyrale, fleksibël, shumë rezistent, e deformueshme (S1), sipas standartit EN 12004 për shtrimin e pllakave qeramikë, gres dhe porcelan, mozaikë prej xhami dhe porcelan, si dhe gurë natyralë dhe artificialë që nuk zbardhen në zonën e dyshemesë dhe murit. Veçanërisht e përshtatshme për dysheme me ngarkesë termike si p.sh. tarrasat, ballkonet dhe dysheme me ngrohje. Në bazamente të deformueshme (si p.sh. beton i ri, kartonxhes gipsi etj), si dhe në suva të vjetra por me aftësi mbajtëse. Vecanerisht e përshtatshme për dysheme dhe pllaka me ngjyrë të hapur dhe shtrimin pllakë mbi pllakë.

## Karakteristikat

- I deformueshëm (klasa S1 – fleksibilitet i lartë)
- Qëndrueshmëri të lartë
- Kohë e zgjatur e hapjes
- Rezistent ndaj ngricave
- I përshtatshëm për ngrohje dyshemeje
- I përshtatshëm për pishina
- Mbi bazamente organike dhe minerale
- I patretshëm në ujë
- teknologji RÖFIX me pak pluhur
- I përshtatshëm për formate të mëdha (shih udhëzimet RÖFIX)

## Përpunimi




## Të dhëna teknike

| Numri i artikullit | 41014 |
|---|---|
| EAN | 9003304410149 |
| Paketimi |  |
| Sasi për njësi | 25 kg/Nj. |
| Njësi për paletë | 54 Nj./Pal |
| Madhësia e kokrrizave | 0-0,5 mm |
| Ngjyra | E bardhë natyrale |
| Konsumi | rreth. 3 kg/m$^2$ |
| Udhëzime për përdorimin | Të dhënat mbi konsumin janë orientuese, ato varen shumë nga karakteristikat e bazamentit dhe nga teknika e aplikimit. |

# RÖFIX AG 610 Bianco FLEX S1

Ngjitës Flex C2 TE S1

| Numri i artikullit | 41014 |
|---|---|
| Njësia e kërkesës për ujë | rreth. 6 L/Nj. |
| Forca në lidhje | ≥ 1 MPa |
| Gati për tu shkelur | rreth. 24 orë |
| I ngarkueshëm pas | 7 d |
| Grupi i ngjitësit për pllaka | C2 TE S1 EN 12004 |
| Koha e përpunimit dhe ngjitjes | 30 min |
| Korigjueshmëria | rreth. 10 min EN 1015-9 |
| Koha e maturimit | 5 min |
| Koha e punueshmërisë | rreth. 3 orë EN 1015-9 |
| Temperatura e nënshtresës | 5-25 °C |
| Gati për bojak | 24 orë (dysheme)<br>12 orë (mur) |
| Këshilla për paketimin | Në thasë letre me mbrojtje kundër lagështisë. |

## Baza e materialit

- Rërë e klasifikuar
- Çimento e bardhë (pa kromate)
- Aditivë për përmirësimin e vetive të përpunimit

## Kushtet e punimit

Gjatë fazës së tharjes dhe përpunimit, temperatura e ambjentit dhe bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C. Deri sa të arrihet tharrja e plotë, mbrojeni nga ngrirja, tharja e shpejtë (rezatimi direkt i diellit, era) dhe shiu.

## Bazamenti

Dyshemetë me bazë çimento- sulfat, çimento, dysheme me bazë sulfat-kalçiumi dhe betone të vjetra, çimento, gëlqere-çimento, gips, dhe suvatë me bazë gëlqere, për të gjitha llojet e bazamenteve duhet të jenë në përputhje me rregulloret dhe normativat. Dyshemetë me bazë sulfat kalciumi duhet të paratrajtohen përpara se të shtrohen me pllaka. Kini parasysh lagështinë e mbetur në varësi të bazamentit. Tek suvatë me bazë gipsi dhe gips- gëlqere sipas EN 13279-1, duhet patur kujdes kur lagështia e mbetur është mbi 1%. Bazamenti duhet të jetë i i qëndrueshëm me aftësi mbajtëse, i pastër, pa plasaritje, pa mbetje vajrash, pa lyerje të vjetra dhe mjaftueshmërisht i thatë.

## Bazamenti-Trajtimi paraprak

Për bazamente me aftësi thithëse përdorni astarin RÖFIX AP 300, ndërsa për bazamente kritike shumicën e rasteve ne sugjerojmë fortësuesin RÖFIX AP 320. Dëmtimet dhe gërvishtjet në sipërfaqe duhet të trajtohen me llaç të përshtatshëm riparimi.

## Përgatitja

Përziejini në mënyrë homogjene me një përzierës mekanik, duke rregulluar mundësisht konsistencën meduke shtuar një sasi të vogël uji. Pasi përziejmë e lemë të pushojë dhe më pas e përziejmë përsëri.

# RÖFIX AG 610 Bianco FLEX S1

Ngjitës Flex C2 TE S1

## Këshilla për përpunimin

Materialin i hapur më parë  nuk duhet përdorur, gjithashtu mos e përzieni me materialin e ri. Pllakat shtrohen në një shtrat të hollë ngjitësi, duke i levizur lehtësisht dhe mund të korrigjohen brenda pak minutave mbas vendosjes në vendin e tyre.
Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.

## Përpunimi

Shtrojeni ngjitësin RÖFIX me anën e lëmuar të mistrisë së përshtatshme dhe me anën e dhëmbëzuar vijëzojeni dhe përhapeni mundësisht vetëm në një drejtim.
Nëse është e nevojshme, të garantohet një shtrim i pllakave pa hapësira (në zona që janë nën ndikimin e vazhdueshëm të ujit) duhet të punohet me metodën Floating- Buttering.
Mos shtroni më shumë ngjitës se sa mund të shtroni pllaka, sepse kolla humb vetinë ngjitëse.
Përzierësit mekanik janë të përshtatshëm veçanërisht për materiale të butë me viskozitet të lartë siç është ngjitësi i pllakave.

## Magazinimi

Magazinojeni në vende të thata mundësisht mbi paleta druri. Koha e magazinimit: min. 12 muaj sipas. Rregullores 1907/2006/EG, Aneksi XVII, në temperaturë +20 °C, 65 % lagështi ambjenti.

## Certifikatë




## Udhëzime teknike dhe ligjore

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skedat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

## Këshilla të përgjithshme

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkojnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme. Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në vetevete nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet ROFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohet një cilësi e pandryshueshme. Stafi ynë është I gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona. Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkohen edhe pranë filjaleve rajonale në vënd.
Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.
Të gjitha të dhënat teknike të dhëna në këtë fletë produkti janë përcaktuar në kushte laboratorike.